

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR {xxx}

Nr.Regj. 00584 - 455
Dataeregj 23.10.2019

Nr.vend. (1194) - 456
Dt.vend.10.12.2019

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS“

Gjykata e Rrethit Gjyqësor {xxx} , e përbërë prej: Kryetar i seancës
{xxx}

asistuar prej sekretares gjyqësore {xxx}, në {xxx} , sot më dt.10.12.2019, ora 11:00 h, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer te hapura kërkesën që iu përket:

KERKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor {xxx} , përfaqësuar nga prokuror {xxx}

OBJEKTI:

Pushimin e procedimit penal nr.494, dt.24/12/2018 për veprën penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale*”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 329/b të Kodit të Procedurës Penale.

P.HETIM: {xxx} i biri i Profi dhe Neftalia, dtl.14.03.1976, lindur në {xxx} dhe banues në qytetin e {xxx} it, Lagja nr.2. (*Sipas informacioneve të mcirra nga Komisariati i Policisë {xxx} , rezulton se ndodhet jashtë shtetit me adresë të panjohur, prandaj gjykata në referim të nenit 352 të KPr.Penale e deklaroi në mungesë dhe caktoi si mbrojtëse av.Luljeta Burnazi*).

{xxx} e bija e Petraq dhe Elvira, dtl.28.06.1978, lindur dhe banuese në {xxx} , Lagja nr.2, (*Sipas informacioneve të marra nga Komisariati i Policisë {xxx} , rezulton se ndodhet jashtë shtetit me adresë të panjohur, prandaj gjykata në referim të nenit 352 të KPr.Penale e deklaroi në mungesë dhe caktoi si mbrojtëse av.{xxx}*).

Në perfundim të shqyrtimit gjyqësor në konkluzionet përfundimtare palët kerkuan:

Përfaqësuesi i prokurorisë kërkoi:

- Pushimin e procedimit penal nr.494, dt.24/12/2018 për veprën penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale*”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal për personat nën hetim {xxx} dhe {xxx} .

Gjykata, pasi shqyrtoi dhe analizoi në tërësi çështjen, administroi provat e paraqitura nga palët dhe dëgjoji konkluzionet përfundimtare:

VËRËN

1. Gjatë gjykimit rezultuan këto fakte e rrethana mbi çështjen të provuara si më poshtë, të cilat i ka parashtruar në kërkesën e saj të pushimit edhe organi i akuzës:

- Prokuroria e Rrethit {xxx} , ka regjistruar procedimin penal nr.494, dt.24/12/2018 për veprën penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale* ”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.
- Departamenti i Krimi të Organizuar dhe Krimeve të Rënda ka disponuar informacion se shtetasit {xxx} dhe bashkëshortia e tij {xxx} kanë aktivitete të dyshimta, konkretisht në lidhje me transfertat e ndryshme të lekëve dhe valutës në euro, pasi përdorte dy emra {xxx} dhe {xxx} . Në dt.23.05.2017 ka derdhur cash në llogarinë {xxx} shumën 90.000 euro, sipas kontratës me nr.1914 rep, nr.868 kol, dt.25.09.2017. Në këtë kontratë është përshkrimi se {xxx} ka dhënë hua 85.000 euro për blerjen e një apartamenti në Greqi. Ky shtetas ka numër llogarie të përbashkët me bashkëshorten e tij {xxx} që prej dt.23.05.2017 të cilën e kanë në monedhën euro. Për shumën prej 90.000 euro të depozituar cash janë vendosur me afat ku është deklaruar se këto të ardhura burojnë nga kursimet familjare, hua nga të afërm dhe nga shitja e automjetit, si dhe zotëron një butik në shtetin Grek. Nga shtetësia {xxx} është paraqitur një kontratë e dt.01.06.2016 për shitjen e një automjeti me vlerë 2. euro shtetasit {xxx}
- Në vijim të verifikimeve të pasurisë së shtetasit {xxx} ka rezultuar se, pasuria dhe transaksionet e mëposhtme:
 - a. Në dt.05.03.2013 ka blerë nga shoqëria “{xxx}” shpk një apartament me vlerë 4.431.0 lekë ku pagesa është bërë cash dhe burimi i të ardhurave nga puna.
 - b. Në dt.23.01.2014 ka prenotuar nga shoqëria “{xxx}” një apartament dhe garazh me sipërfaqe totale 125 m2 me vlerë 119.000 euro. Mënyra e pagesës është deklaruar me transfertë bankare dhe burimi i të ardhurave personale.
 - c. Në dt. 12.05.2015 i ka shitur shtetasit shtetasit {xxx} një automjet në vlerën 13.0 euro.
 - d. Në dt. 15.07.2015 ka prenotuar nga shoqëria “{xxx}” shpk një dyqan dhe një vend parkim në vlerën 62.000 euro. Mënyra e pagesës është deklaruar me transfertë, në bazë të mandatit të lëshuar nga {XXX} dt.08.07.2015.
 - e. Në periudhën janar - dhjetor 2012 ka disa transaksione bankare vlere e të cilave arrin në 9.640.0 lekë , 70.756 euro kryesisht në {xxx} .

- Në vijim të verifikimeve të pasurisë së shtetases {xxx} ka rezultuar , pasuria dhe transaksionet e mëposhtme:
 - a. Në dt.21.08.2013 ka blerë nga shtetësia {xxx} një apartament banimi me vlerë 3.267.641 lekë. Mënyra e deklarimit të pagesës cash. Burimi i të ardhurave nga emigracioni.
 - b. Në dt.27.01.2012 ka blerë nga shtetasi {xxx} një njësi me vlerën 4.430.700 lekë. Mënyra e pagesës është deklaruar cash dhe burimi i të ardhurave nga emigracioni.
 - c. Për periudhën korrik 2009- maj 2017 ka një numër të konsiderueshëm transaksionesh bankare me vlera që arrijnë deri në 100.000 euro, 13.048.270 lekë kryesisht në {xxx}, {xxx} , Societe {xxx}, {XXX} ku natyre e veprimeve është e tipit derdhje cash, tërheqje, pagesa, këmbime, kalim në depozitë, ku vlerësohet se në dt. 13.12.2013 ka derdhur në llogarinë {XXX} shumën 100.000 euro. Burimi i të ardhurave nga emigracioni.
 - d. Në dt.23.05.2017 ka derdhur në llogarinë bankare në {xxx} shumën prej 15.000 euro.
- Të dhënat e konstatuar më sipër, kanë krijuar dyshim të arsyeshëm se, shtetasit {xxx} dhe {xxx} janë përfshirë në veprimtarinë kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale, pasi është bërë një derdhje në cash në vlerën 90.000 euro, mbajtja e gjeneraliteteve të tjera të {xxx}, ka investuar në pasuri të paluajtshme në total 212.878 euro. Brenda së njëjtës ditë (dt. 12.05.2015) ka blerë dhe ka shitur po të njëjtit person automjet, por duke e ulur vlerën e saj nga 20.000 euro në 13.000 uro. Shtetësia {xxx} ka investuar në pasuri të paluajtshme në total 55.384 euro, ku në emër të saj ka transaksione bankare në vlera të konsiderueshme.
- * Në kuadër të verifikimeve të mëtejshme të pasurisë, Seksioni i Krimeve Ekonomike pranë D.V.P. {xxx} ka verifikuar nëse shtetasit e mësipërm kanë bërë aplikim në zyrën e ALUIZNIT për donjë objekt informal dhe rezultoi se nuk ishte bërë aplikim. Po kështu nga A.SH.K {xxx} nuk del se këta persona te kenë pasuri të regjistruara. Nga Drejtoria Rajonale Tatimore {xxx} rezulton se shtetasi {xxx} është i regjistruar me Nipt L33729601 A, tregëti me pakicë të veshjeve, por që nuk ka deklaruar të ardhura dhe pagesa, ndërsa pjestarët e tjerë të familjes nuk rezultojnë të jenë regjistruar.
- Nga verifikimi që është bërë në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor ka rezultuar se, shtetasi {xxx} ka pasur tre mjete dhe i ka shitur dhe aktualisht ka një mjet me targë AA 588 BS. Shtetasi {xxx} ka pasur në pronësi mjetet me targa, AA 733 JO, AA 626 KN dhe AA 077 IR, ndërsa shtetësia {xxx} ka pasur në pronësi mjetet me targa AA588 BS, AA 733 JO, AA 626 KN dhe AA 223 JK, ku dy mjete kanë qenë në pronësi së bashku me bashkëshortin e saj, ndërsa familjarët e saj nuk kanë të regjistruar donjë mjet motorik.
- Nga verifikimi në O.S.SH.E rezulton se shtetasi {xxx} është i regjistruar me tre numra kontratash një një {xxx} KR1A010021042648 dhe në {xxx} dy numra TR 10030479638642, ndërsa në emër të shtetases {xxx} rezulton një kontratë në qytetin e {xxx} it me Nr.KR1AO10114051040.
- Nga të dhënat e mbledhura nga sigurimet shoqërore rezulton se, shtetasi {xxx} është i regjistruar dhe ka derdhur kontribute për vitin 2013 si dhe për tre muaj për vitin 2014, ndërsa {xxx} dhe familjarët nuk rezultojnë të siguruar.
- Nga verifikimet që janë bërë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave rezulton se shtetasi {xxx} të ketë kryer një procedurë doganore, por nuk rezulton të ketë kryer procedurë për deklarim para cash apo sende me vlerë.
- Nga verifikimi i A.SH.K Tiranë rezulton se shtetasi {xxx} ka katër pasuri të paluajtshme në qytetin e Tiranës apartament me sipërfaqe 90 m², ZK 8260, Njësi me

sipërfaqe 54.50 m², ZK 8280, Garazh me sipërfaqe 12.50 m², ZK 8260, Garazh me sipërfaqe 16 m² me një vlerë totale 181.000 euro.

- Gjatë hetimeve paraprake rezulton se shtetasi {xxx} ka deklaruar se, është i pajisur me pasaportë greke dhe ka 30 vite që punon në këtë shtet, aktualisht ka si aktivitet taksisti që banon në Athinë, po kështu në lidhje me të ardhurat e tij shpjegon se janë mbledhur nga emigracioni në shtetin Grek së bashku me bashkëshorten, të ardhurat të cilat një pjesë i ka hedhur duke blerë pasuri të paluajtshme në qytetin e {xxx} it e Tiranës, kurse pjesën tjetër të të ardhurave i mban të depozituara në llogari bankare. Të ardhurat e mbledhura nga emigracioni i ka sjellë herë pas herë nëpërmjet pikës së kalimit kufitar si dhe me të afermit e tij, por pa kaluar kufirin që ato duhet të deklarohen në doganë. Para disa vitesh ka hapur një aktivitet privat në Shqipëri dhe më pas e ka mbyllur se nuk kishte fitim. Gjithashtu është deklaruar se në qytetin e {xxx} it ka 2 hyrje pallatesh si dhe dy garazhe, po kështu në qytetin e Tiranës ka një hyrje pallati, një dyqan dhe dy garazhe. Në lidhje me këto pasuria ky shtetas ka sjellë dhe dorëzuar në organin procedues në cilësinë e provës materiale, dokumentacion nga shteti Grek të përkthyer dhe të noterizuar ku provojnë të ardhura dhe regjistrime në tatime në shtetin Grek, si dhe vërtetim të gjendjes gjyqësore që ky shtetas nuk është i dënuar.
- Gjatë hetimeve paraprake rezulton se shtetasia {xxx} ka deklaruar se, ka punuar në shtetin Grek si gjithë emigrantët e tjerë shqiptarë në punë të zezë fillimisht, e se të ardhurat që ndodhen në bankat e shqipërisë janë sjellë si rezultat i punës së tyre si bashkëshortë, po kështu është deklaruar se një llogari është e djalit të saj cili është me KEMP për shkak të problemeve shëndetësore.
- Është sekuestruar me procesverbalin përkatës, materialet e ardhura nga autoritetet greke, të përkthyer dhe noterizuar, ku rezulton se për vitin 2018 ka deklaruar si të ardhura bmt 27.913 euro, ndërsa si fitimi është deklaruar shuma prej 9.276 euro. Këto të ardhura e kanë burimin nga paga dhe aktiviteti tregëtar.

2. Rrethanat e mësipërme u provuan me provat e paraqitura nga organi i akuzës, të cilat janë administruar në gjykim në cilësinë e provave shkresore:

- Kërkesë “Për pushimin e çështjes”.
- Urdhër “Për regjistrimin e procedimit penal” nr.494, dt.24/12/2018.
- Shkresa me nr. 15204/1 prot, dt. 17.10.2017 lëshuar nga Drejtoria për Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar.
- Procesverbal “Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale” dt.19.12.2018 (printime nga sistemi TIMS, bashkëlidhur fletët e printuara nga sistemi TIMS).
- Procesverbal “Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale” dt.27.09.2019 (dokumenta në gjuhën greke të përkthyer dhe noterizuar).
- Procesverbal “Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale” dt.24.09.2019 (dokumentacioni i pronësisë së paluajtshme).
- * Procesverbal “Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale” dt.04.10.2019, për hryrjet dhe daljet e shtetasis {xxx} (printime nga sistemi TIMS, bashkëlidhur fletët e printuara nga sistemi TIMS).
- * Procesverbal “Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale” dt.06.08.2019 (fotokopje e njëhësuar me origjinalin e lejës së qarkullimi të mjetit taksisti).
- Procesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” dt.28.05.2018 nga shtetësia {xxx} .
- Procesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”

dt.05.08.2019 nga shtetësi {xxx} .

- Shkresa me nr.4042/1 prot, dt.19.12.2019 lëshuar nga D.SH.T.R
- Shkresa me nr.400/1 prot, dt.28.02.2019 lëshuar nga O.S.SH.E (bashkëlidhur kontratat e energjisë elektrike)
- Shkresa me nr.3615/1 prot, dt.26.02.2019 lëshuar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor (bashkëlidhur materialet përkatëse).
- Shkresa me nr.2, dt.20.02.2019 lëshuar nga Zyra Qendore Kombëtar Interpol.
- Shkresa me nr.61 prot, dt.27.05.2019 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Nj.A.Allkaj, Bashkia {xxx} .
- Shkresa me nr.2087 prot, dt.18.03.2019 lëshuar nga Drejtoria e Arkivit Qendor (bashkëlidhur vërtetimet përkatëse).
- Shkresa me nr.1622/1 prot, dt.25.02.2019 lëshuar nga Zyra Qendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
- Shkresa me nr.7824 prot, dt.07.03.2019 lëshuar nga Z.V.R.P.P Tiranë (bashkëlidhur materialet e pronësisë).
- Shkresa me nr.2234/1 prot, dt.02.03.2019 lëshuar nga Z.V.R.P.P {xxx}
- Shkresa me nr.5683 prot, dt.22.02.2019 lëshuar nga {xxx} (bashkëlidhur lëvizjet e llogarisë).
- Shkresa me nr.3689 prot, dt.22.02.2019 lëshuar nga {xxx} (bashkëlidhur lëvizjet e llogarisë).
- Shkresa me nr.814 prot, dt.08.03.2019 lëshuar nga {XXX} (bashkëlidhur lëvizjet e llogarisë ndër vite).
- Shkresa me nr.1748 prot, dt.08.04.2019 lëshuar nga {xxx} (bashkëlidhur lëvizjet e llogarisë).
- * Shkresa me nr.707/4 prot, dt.05.03.2019 lëshuar nga Societe Generale Bank (bashkëlidhur lëvizjet e llogarisë).
- Njoftim “Për përfundimin e hetimeve” dt.09.10.2019

II. VLERËSIMI GJYKATËS

> **Tiparët e gjykimit të posaçëm për miratimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes.**

3. Miratimi i kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale, është një insitut i ri i futur në K.Pr.Penale, me ndryshimet që i janë bërë me Ligjin Nr. 135/2017. Më përpara prokurori e merrte vetë vendimin për pushimin e çështjes penale dhe kontrolli i vendimarrjes së prokurorit bëhej nëpërmjet ankimit nga pala e interesuar, kundër vendimit të pushimit të çështjes në gjykatë. Qëllimi i këtij insituti është që të forcohet kontrolli i veprimtarisë së prokurorisë, nga gjykata, sidomos për një veprim hetimor që fmalizon veprimtarinë hetimore të organit të akuzës, vendimin e pushimit të çështjes. Duke u nisur nga fakti se çdo vendim pushimi i prokurorit do të kontrollohet nga gjykata, e bën organin e akuzës më të përgjegjshëm dhe serioz në veprimtarinë e tij hetimore, me qëllim që hetimet të jenë të plota dhe të gjithëanshme.

4. Një element i rëndësishëm që e disiplinon organin e akuzës, për vendimin e pushimit të çështjes që do t'i dërgojë gjykatës për miratim është kompetenca që ka gjykata e parashikuar nga neni 329/3/c të K.Pr.Penale, sipas të cilit gjykata vendos kthimin e akteve prokurorit duke urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur çmon se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur akuzën.

5. Në këtë kontekst, gjykata vlerëson se ka vend për përgjegjësinë penale të pandehurit dhe çështja ka nevojë t'i nënshtrohet hetimit gjyqësor për të përcaktuar elementët e përgjegjesisë penale, për veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Natyrisht që gjykata nuk shprehet për fajësinë e të pandehurit, por nga aktet që ndodhen në fashikullin e procedimit vlerëson se përgjegjësia penale e të pandehurit nuk përjashtohet dhe ka nevojë që kjo të përcaktohet përfundimisht me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Kjo kompetencë e gjykatës, e detyron organin e akuzës që të jetë më i matur dhe i bindur kur i kërkon gjykatës pushimin e çështjes penale dhe të kryejë veprime hetimore të plota për të cilat gjykata nuk ka nevojë që të investohet për gjetjen e provave të reja apo provave që mund të merreshin nga organi i akuzës, pra kryerjen e atyre veprimeve hetimore që janë të përshtatshme për t'u kryer nga prokuroria për shak të karakterit dinamik që ka. Përfundimisht gjykata çmon se marrja e vendimit të pushimit të çështjes nga gjykata me kërkesë të prokurorisë, ndikon në rritjen e cilësisë së veprimeve hetimore dhe vlerësimin më drejt dhe profesionalizëm të prokurorisë të elementëve të veprës penale.

7. Gjkata vlerëson të theksojë se në rastin kur gjykon kërkesat për pushimin e çështjes, në zbatim të nenit 329/b/3, të K.Pr.Penale, në rast se konstaton se hetimet janë të paplota vendos t'ia kthejë aktet prokurorit, duke përcaktuar edhe veprimet hetimore që janë të nevojshme për t'u kryer dhe përcakton dhe një afat për përfundimin e tyre. Këtu duhet të kihet parasysh se gjykata nuk mund të urdhërojë prokurorinë të kryejë veprime hetimore të cilat janë periferike, të padobishme dhe nuk ndikojnë në përcaktimin e elementëve të veprës penale. Gjkata urdhëron prokurorin të kryejë veprime hetimore apo kryerjen e veprimeve procedurale, që besohet se me provat e marra prej tyre, mund të jenë përcaktuese për ndarjen e kufirit midis përgjegjësi civile, administrative dhe asaj penale.

8. Gjkata thekson se nuk mund të marrë rol aktiv për mbledhjen vetë të një ose disa provave, nuk mund të marrë në shqyrtim dhe as të vlerësojë provat e mbledhura deri në atë fazë të hetimeve paraprake, pra, mund të kontrollojë ligjshmërinë e veprimeve të prokurorisë dhe plotëshmerinë e hetimeve paraprake si parim i rëndësishëm procedural, por jo ta zëvendësojë këtë institucion kushtetues.

> **Në l'ulh'ie me pushimin e çështjes në rasti objekt gjykimi.**

9. Vepra penale "*Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*" parashikohet në nenin 287 të Kodit Penal i cili ka parashikuar një listë të gjatë të rasteve, formave dhe mënyrave me të cilat kryhet kjo vepër penale.

10. Kjo vepër penale ka pësuar ndryshime pesë herë, për të forcuar luftën kundër krimit të organizuar dhe për të reflektuar normat juridike të parashikuara në instrumentat ndërkombëtare,

të cilat Shqipëria i ka ratifikuar në kuadër të pjesmarrjes së saj në organizatat ndërkombëtare dhe në kuadër të integritimit në Bashkimin Europian. Konkretisht është ndryshuar me Ligjin Nr.9086, dt. 19/06/2003, Ligjin Nr.9275, dt. 16/09/2004, Ligjin Nr.9686, dt.26/02/2007, Ligjin Nr.23/2012, Ligjin Nr. 114/2013.

11. Kjo dispozitë aktualisht ka këtë përmbajtje: *“Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale nëpërmjet:*

- a) Këmbimit ose transferimit të pasurisë me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.*
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit zhvendosjes, të pronësisë ose të drejtave që lidhen me pasurinë duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.*
- c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë duke e ditur në çastin e marrjes së saj në dorëzim se është produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.*
- ç) Kryerjen e veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi sipas legjislacionit të parandalimit të pastrimit të parave.*
- d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur që janë produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.*
- dh) këshillimit, nxitjes, ndihmës ose thirrjes publike për kryerjen e secilave veprave të përcaktuara më sipër dënohet me burgim nga pesë deri në 10 vjet.*

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

- a) Vepra penale produktet e të cilës pastrohen është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet.*
- b) Ndjekja penale për veprën, produktet e të cilës pastrohen është parashkruar ose amnistuar.*
- c) personi që ka kryer veprën penale është i njëjtë me personin që ka kryer veprën nga e cila kanë rrjedhur produktet*
- ç) për veprën penale nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale ose nuk është dhënë donjë vendimi dënimi i formës së prerë.*
- d) vepra penale produktet e të cilës pastrohen është kryer nga një person pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme si në shtetin e huaj, ashtu edhe Republikën e Shqipërisë.*

12. Në interpretim të nenit 287 të Kodit Penal, përgjegjësia penale ekziston për këtë vepër penale e mëvetësuar edhe nga vepra penale kryesore nga e cila kanë rrjedhur astetet kriminale. Mjafton që të ketë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se personi që ka pasuri e cila buron nga veprimtari të paligjshme, dyshohet se mund të jetë përfshirë në veprimtari kriminale. Niveli i provueshmërisë së veprës penale kryesore, nga e cila dyshohet se kanë ardhur produktet e veprës penale, nuk kërkohet në atë shkallë që kërkohet për veprat penale në përgjithësi, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

13. Përgjegjësia penale në bazë të kësaj dispozite, ka disa veçori, që e dallojnë nga përgjegjësia penale për veprat penale të tjera, të parashikuara nga Kodi Penal, të cilat janë pasqyruar në mënyrë më të zgjeruar në Ligjin Nr.10 192, dt.03/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit korupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese të pasurisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr.24/2014 dhe Ligjin Nr.70/2017.

14. Bara e provës për të justifikuar burimin e të ardhurave, i takon të pandehurit ose personit që dyshohet se zotëron pasuritë e paligjshme, në lidhje me pasuritë që dyshohen se janë produkt i veprës penale. Kjo vepër penale dënohet edhe pasi është parashkruar ose është aminstuar vepra penale kryesore. Po kështu vlen të theksohet se përgjësia penale për këtë vepër penale shtrihet jo vetëm te personi që dyshohet se ka kryer ose mund të ketë kryer veprën penale kryesore , por edhe te persona që kanë kryer një nga format ose mënyrat e parashikuara nga nenit 287 i Kodit Penal, për pastrimin e produkteve të veprës penale.

15. Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme edhe në rastet kur procedohet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, sipas nenit 3, pika 1, gërma ç, të Ligjit Nr.10 192, dt.03/12/2009. Përsa i përket juridiksionit për gjykimin e masave me karakter parandalues, sipas këtij ligji, referuar nenit 3 dhe 7 të këtij ligji, gjykata me juridiksion të përgjithshëm, dmth gjykatat e shkallës së parë, kanë kompetencë për shqyrtimin e masave parandaluese, me karakter pasuror, që lidhen me veprat penale që nuk janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda ose Gjykatës Antikorupsion.

16. **Gjatë gjykimit rezultoi e provuar se,** Departamenti i Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda ka disponuar informacion se shtetasit {xxx} dhe bashkëshortia e tij {xxx} kanë aktivitete të dyshimta, konkretisht në lidhje me transfertat e ndryshme të lekëve dhe valutës në euro, pasi përdorte dy emra {xxx} dhe {xxx} ,.

17. Në dt.23.05.2017 ka derdhur cash në llogarinë {xxx} shumën 90.000 euro, sipas kontratës me nr.1914 rep, nr.868 kol, dt.25.09.2017. Në këtë kontratë është përshkrimi se {xxx} ka dhënë hua 85.000 euro për blerjen e një apartamenti në Greqi. Ky shtetas ka numër llogarie të përbashkët me bashkëshorten e tij {xxx} që prej dt.23.05.2017 të cilën e kanë në monedhën euro.

18. Për shumën prej 90.000 euro të depozituar cash janë vendosur me afat ku është deklaruar se këto të ardhura burojnë nga kursimet familjare, hua nga të afërm dhe nga shitja e automjetit, si dhe zotëron një boutik në shtetin Grek. Nga shtetësia {xxx} është paraqitur një kontratë e dt.01.06.2016 për shitjen e një automjeti me vlerë 2.000 euro shtetasit {xxx}.

19. Në vijim të verifikimeve të pasurisë së shtetasit {xxx} ka rezultuar se, pasuria dhe transaksionet e mëposhtme:

- f. Në dt.05.03.2013 ka blerë nga shoqëria “{xxx}” shpk një apartament me vlerë 4.431.000 lekë ku pagesa është bërë cash dhe burimi i të ardhurave nga puna.
- g. Në dt.23.01.2014 ka prenotuar nga shoqëria “{xxx}” një apartament dhe garazh me sipërfaqe totale 125 m² me vlerë 119.000 euro. Mënyra e pagesës është deklaruar me transfertë bankare dhe burimi i të ardhurave personale.
- h. Në dt.12.05.2015 i ka shitur shtetasit shtetasit {xxx} një automjet në vlerën 13.000 euro.
- i. Në dt. 15.07.2015 ka prenotuar nga shoqëria “{xxx}” shpk një dyqan dhe një vend parkim në vlerën 62.000 euro. Mënyra e pagesës është deklaruar me transfertë, në bazë të mandatit të lëshuar nga {XXX} dt.08.07.2015.
- j. Në periudhën janar - dhjetor 2012 ka disa transaksione bankare vlera e të cilave arrin në 9.640.000 lekë , 70.756 euro kryesisht në {xxx} .
- Në vijim të verifikimeve të pasurisë së shtetasës {xxx} ka rezultuar , pasuria dhe transaksionet e mëposhtme:
 - e. Në dt.21.08.2013 ka blerë nga shtetësia {xxx} një apartament banimi me vlerë 3.267.641 lekë. Mënyra e deklarimit të pagesës cash. Burimi i të ardhurave nga emigracioni.
 - f. Në dt.27.01.2012 ka blerë nga shtetasi {xxx} një njësi me vlerën 4.430.700 lekë. Mënyra e pagesës është deklaruar cash dhe burimi i të ardhurave nga emigracioni.
 - g. Për periudhën korrik 2009- maj 2017 ka një numër të konsiderueshëm transaksionesh bankare me vlera që arrijnë deri në 100.000 euro, 13.048.270 lekë kryesisht në {xxx}, {xxx} , {xxx}, {XXX} ku natyre e veprimeve është e tipit derdhje cash, tërheqje, pagesa, këmbime, kalim në depozitë, ku vlerësohet se në dt. 13.12.2013 ka derdhur në llogarinë {XXX} shumën 100.000 euro. Burimi i të ardhurave nga emigracioni.
 - h. Në dt.23.05.2017 ka derdhur në llogarinë bankare në {xxx} shumën prej 15.000 euro.

20. Rezultoi gjatë gjykimit, se personat nën hetim {xxx} dhe {xxx} bashkëshortë njëri me tjetrin kanë një kohë të gjatë që jetojnë në shtetin Grek prej 30 vjetësh, duke paraqitur edhe pasaportën greke e cila është administruar fotokopje të njëhësuar nga organi procedues. Fakti që personat nën hetim kanë jetuar jashtë shtetit në Greqi për një periudhë kaq të gjatë, është e pranueshme që me kursimet e tyre, të kenë blerë apartament në qytetin e {xxx} it dhe Tiranës si dhe dy garazhde.

21. Gjatë gjykimit rezultoi e provuar se, personi nën hetim {xxx}, ka kryer transaksionet financiare si vijon më poshtë:

- a. Për periudhën korrik 2009- maj 2017 ka një numër të konsiderueshëm transaksionesh bankare me vlera që arrijnë deri në 100.000 euro, 13.048.270 lekë kryesisht në {xxx} {xxx} , {xxx}, {XXX} ku natyre e veprimeve është e tipit derdhje cash, tërheqje, pagesa, këmbime, kalim në depozitë, ku vlerësohet se në dt. 13.12.2013 ka derdhur në llogarinë {XXX} shumën 100.000 euro. Burimi i të ardhurave nga emigracioni.

b. Në dt.23.05.2017 ka derdhur në llogarinë bankare në Tirana Bank shumën prej 15.000 euro.

22. Personat nën hetim kanë paraqitur gjatë hetimeve paraprake, deklaratat tatimore të përvitshme në shtetin Grek, në lidhje me të ardhurat e tyre, tregon faktin se kanë qenë emigrant të ligjshëm, po kështu kihet parasysh se, jo gjithmonë emigrantët kanë deklaruar të ardhurat reale, për shkak të gjendjes ekonomike, por një minimum të ardhurash, por realisht ata përfitojnë më shumë se dyfishin e të ardhurave të deklaruara.

23. Shumat e transaksioneve prej 100.000 euro dhe 13.048.270 lekë të kryera gjatë vitit 2009-2017 nuk përbëjnë dyshime të forta që të ngrihen në nivelin e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal “*Pastrim i produkteve të veprës penale*” përderisa personat nën hetim janë shtetas Grek, të cilët punojnë më shumë se 30 vjet në këtë shtet, fakti që nuk rezultojnë të dënuar më përpara, si dhe nuk kanë precedentë penale si të përfshirë në vepra penale që lidhen me krimin e organizuar apo me trafikimet e paligjshme.

24. Për sa më sipër, gjykata e gjen të drejtë qëndrimin e organit të akuzës, se fakti nuk përbën veprë penale, në referim të nenit 328/1/b të K.Pr.Penale.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 329, gërma b, pika 3, të Kodit të Procedures Penale,

V E N D O S I :

- Pushimin e çështjes për procedimin penal nr.494, dt.24/12/2018 për veprën penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale*”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal për personat nën hetim {xxx} dhe {xxx} .
- * Shpenzimet gjyqësore sikurse janë bërë.
- Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë të bëjnë ankim brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, në Gjykatën e Apelit {xxx}.

U shpall ne {xxx} sot me dt.10.12.2019.

SEKRETARE

{xxx}

G J Y Q T A R

{xxx}



^ ate hetimit dhe gjykimit - 3 000 Leke.